

# APIS

Shoqata Bletare Informativ dhe Këshilluese

## APIS

Është revistë periodike informative apikulturore që përgatitet si rezultat i realizimit të pilot proektit: "Ngritja e shërbimit privat këshillues në bletari në R. e Maqedonisë". Finansiarisht i mbështetur nga MAASP (Proekti për zhvillimin e shërbimeve këshilluese bujqësore në Maqedoni), i koordinuar nga qendra e repro-trajnitimit APICENTAR (APIQENDËR) dhe Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit në Shkup.

Sh.B. NEKTAR – Manastir

Vasko Karadakovski

Sh.B. BRATSTVO - Prilep

Dejan Boshkoski

Sh.B. MATICA - Shkup

Ivan Dodevski

Sh.B. MATICA - Vinicë

Ilço Kostadinovski

Sh.B. PÇELLA - Kumanovë

Sreçko Stankovski

Sh.B. MLEÇ– Strumicë

Vojislav Katranxhiev

Sh.B. MALEShEVSKA PÇELLA –  
Berovë

Emilija Rushkovska

Sh.B. PÇELLA – Probishtip

Goran Gjurovski

Sh.B. SHAROPIN – Gostivar

Mersel Xhaferi

Sh.B. ZLATNA MATICA - Kavadar

Pere Rizov

**Redaktorë i APIS:**

Vasko Karadakovski

**Ndihmës redaktorë:**

Sreçko Stankovski

**Redaktorë i APIS (Gjuhë Shqipe)**

Valon Mustafi

**E shpallur në:**

[www.apicentar.com.mk](http://www.apicentar.com.mk)

[www.pcela.mk](http://www.pcela.mk)



Në rrethinën e Prilepit së bashku në dy bletore kanë gjithsej 400 koshere. Përveç helmit të bletëve, prodhojnë mjaltë, propolis, polen dhe qumësht matke. "Për prodhimin e helmit të bletëve është e nevojshme që bletorja të jetë e izoluar dhe larg vendbanimeve, për arsye se bletët gjatë këtij procesi bëhen mjaft agresive dhe si pasojë mund të ndodhin gjëra të padëshirueshme" - thotë Goce Mirçevski, bletarë.

Foto: Ilço Kostadinovski

Prodhimet i plasojnë në vend. Posedojnë edhe shitoren e tyre. Thonë se nga bletaria jetohe mirë, por megjithatë sukcesi më së shumti varet nga kushtet klimatike, krahas dijës, gjendjes dhe kondicionit të bletëve. "Disa vite jo të mbarë, mund të çojnë edhe në kolaps. Ne deri më tani patëm dy vite të thata, që me mjaft vështirësi i kaluam. Por nëse gjithçka është në rregull, atëherë mund të jetohe edhe nga bletaria" - thotë Goce Mirçevski. Punët rreth bletëve, familja Mirçevski i kryen me kënaqësi. Babai dhe djali shkëlqyeshëm e kanë shkrië teorinë dhe praktikën, njëri me përvojën e tij e tjetri me entuzijazmin dhe dëshirën për përsosjen e mëtutjeshme të veprimtarisë. Edhe pas gjith këtyre viteve, planet për të ardhmen nuk mbarojnë. Nëqoftëse gjejnë dhe ju ofrohet plasman adekuat e i sigurt, planifikojnë të mbledhin edhe helmin e bletëve për industrinë farmaceutike.

Goce Mirçevski është anëtarë i Sh.B. MATICA - Shkup (verejtje e redaktorit)

Marrë nga A1.

## Lajmërim nga Shoqatat e Bletarëve

### Sh.B. MATICA - Vinicë

Në Vinicë dhe rrethinë bletarët kanë probleme serioze me dëmtuesin e njohur si Merops Apiaster. Ky shpend i rrallë dhe mjaft i bukur paraqet një ndër dëmtuesit më të mëdhenj të bletëve. *Më shumë në faqe 4.*

Ilço Kostadinovski

### Sh.B. NEKTAR - Manastir

Më 12 Korrik, përfaqësuesit e Sh.B. NEKTAR - Manastir morrën pjesë në mbledhjen e trupit punues të shërbimit këshillues bletar. Në mbledhje morrën pjesë edhe përfaqësues të shoqatave tjera bletare.

Pas mbledhjes, trupi punues e vizitoi bletoren e APICENTAR, ku Aleksandar Uzunov i njoftoi mysafirët me të gjitha aktivitetet e kësaj qendre, duke filluar nga prodhimi i matkave dhe nukleuseve e deri te studimet shkencore që bëhen në bletoret e qendrës APICENTAR.

Vasko Karadakovski

### Sh.B. BRATSTVO - Prilep

Më 21.06.2010 trupi udhëheqës i Sh.B. BRATSTVO zgjodhi kryetar të ri pas skadimit të mandatit të z. Zafir Zafirovskit, i cili refuzoi që t'a shfrytëzojë të drejtën e mandatit te dytë. Kryetarë i ri u zgjodh sekretari i deritanishëm, z. Dushko Dabeski, ndërsa në vend të tij si sekretar u zgjodh z. Orce Todoroski.

Më 30.06.2010 komisioni tre anëtarësh mjaltin e grumbulluar nga taksat e anëtarëve të shoqatës ia dhuruan qendrës për përkujdesje sociale, dedikuar për fëmijët me nevoja të veçanta dhe familjeve kujdestare.

Dejan Boshkoski



## MATKA (AMA) DHE RENDIMENTI

Në literaturën e vjetër rekomandohet dhe pothuajse ka qenë përvojë largimi apo marrja e matkës përpara kullotës kryesore nga shoqëria e bletëve me qëllim të rritjes së rendimentit. Ja se çfarë thotë shkencën për prezencën e matkës në një koshere gjatë kullotës kryesore dhe ndikimin e saj: Prezenca e matkës në familjen e bletëve gjatë kullotës kryesore është mjaft e rëndësishme në procesin e mjaltëprurjes dhe shfrytëzimit e suksesshëm të kullotës. Gjatë mungesës së matkës në familjen e bletëve ngadalësohen (zvogëlohen), e pastaj edhe plotësisht ndërpriten funksionet themelore, siç janë: tajimi i dyllit dhe ndërtimit të piteve (fletëve) të dyllit – hojeve, mbarërritjen e larvave, mbledhja e nektarit dhe polenit e përpunimi e tyre. Me paraqitjen e matkës në shoqërinë e bletëve të gjitha këto funksione gradualisht rinovohen.

Shkenctarët detalisht e kanë studijuar ndikimin e matkës dhe shtratit të larvave në intenzitetin e shfrytëzimit të kullotës. Dallohen 4 periudha karakteristike nga largimi i matkës deri te kthimi në gjendje normale të familjes së bletëve.

**Periudha e parë:** fillon nga momenti i largimit (menjanimit) të amës dhe mbaron me fillimin e ndërtimit të qelëzave të amës (amëzorëve). Kjo periudhë nuk zgjat shumë. Pas 30'-50 minuta nga largimi i matkës nga shoqëria, bletët fillojnë ndërtimin e qelëzave të matkës mbi larva me moshë të ndryshme. Karakteristike për këtë periudhë është rritja drastike e importimit të ushqimit në koshere për rreth 65% (për dallim nga shoqëria me amë, këtu bletët janë rentabile vetëm 35%).

**Periudha e dytë:** fillon nga ndërtimi i qelëzave të matkës dhe zgjat deri te çelja e tyre apo lindja e amëzave. Pra, kohëzgjatja e kësaj periudhe është prej 9-12 ditëve, varësisht nga moshja e larvave mbi te cilat janë ndërtuar qelëzat e amëzave (3 ditë vezë + 1 ditë larvë + 12 ditë = 16 ditë ose 3 ditë vezë + 4 ditë larvë + 9 ditë = 16 ditë). Pas fillimit të ndërtimit të qelëzave bletët e rrisin rendimentin (prodhueshmërinë), por ende nuk e arrijnë nivelin e shoqërive të cilat kanë pasur matkë. Kjo periudhë karakterizohet me zvogëlimin e sasisë së vezëve dhe shtratit të larvave si dhe me zvogëlimin e aktivitetit në aspektin e importimit të ushqimit, d.m.th. rendimenti në shoqërinë ku mungon matka është 25% më i vogël.

**Periudha e tretë:** fillon me çeljen e qelëzave të matkës dhe mbaron atëherë kur matka e re e mbarësuar fillon të pjellë vezë. Kjo periudhë zgjat rreth 14 ditë. Karakterizohet me zvogëlimin e aftësive të bletëve për punë dhe mbledhjes së ushqimit për 60%.

**Periudha e katërt:** fillon me paraqitjen e vezëve të para nga matka e re e mbarësuar e zgjat prej 12-18 ditë. Karakterizohet me atë se shoqëria e bletëve sillejt si një roj i ri, me një aktivitet të madh. Importimi i ushqimit rritet për 155%. Pas mbarimit të kësaj periudhe kjo vlerë shpejt bie dhe bëhet më e ulët krahasuar me shoqëritë në të cilat ama ka qenë prezente gjatë gjithë kohës.

Nga studimi shkencorë shumëvjeçarë është vërtetuar se mungesa e matkës së mbarësuar në shoqërinë e bletëve në kohën e kullotës kryesore, jo që rrit, por përkundrazi sjell deri në zvogëlimin e produktivitetit të mjaltit për 42%. Zëvendësimi i matkës me qelëz të pjekur (arrirë) për një kohë të shpejtë e kthen shoqërinë e bletëve në gjendje normale. Kolonive të cilave u mungon ama punojnë me një intenzitet dhe elan më të ulët 27 ditë, ndërsa në shoqëritë me qelëz të arrirë të matkës, 18 ditë.

Në bazë të asaj që u tha deri më tani mund të përfundojmë se gjatë kohës së kullotës kryesore s' duhet të largohet matka, por as edhe të ndërrohet. Zëvendësimi i saj më së miri është të kryhet përpara kullotës kryesore, ashtuqë para fillimit të saj shoqëria të ketë matkë të re e të mbarësuar. Në prodhueshmërinë apo rendimentin e shoqërisë së bletëve përveç prezencës së matkës rol të veçantë luan edhe moshja dhe kualiteti i saj. Shoqëritë me amë një vjeçare kanë pasur me tepër rendiment për 42% ndërsa ato me dy vjeçare 20% më tepër rendiment se shoqëria me amë tre vjeçare (megjithatë kjo nuk vlen në të gjitha rastet).

**Bletarë: Kitançev Ice – Ohër**  
www.pcela.mk

## Aktivitetet mujore në bletore (kopshtin e bletëve)

### Korrik

Kontrollet dhe aktiviteti në këtë periudhë në bletore është pasqyrë dhe fazë parapërgatitore për kosheret e bletëve për periudhën e mëvonshme vjeshtore dhe dimërimin e tyre. Bletarët duhet t'a kenë parasysh se renditja dhe vendosja e drejtë e kornizave në koshere, ndërtimi i fletëve (piteve) të dyllit, shtrimi i vezëve në hojet e reja nga matka, sigurimi i ushqimit rezervë gjatë këtij muaji mund të kryhet shumë më lehtë dhe në mënyrë më cilësore se sa më vonë, kur edhe pasojat ndaj shoqërive të bletëve mund të jenë më të mëdha. Pra, me këtë do t'ju ndihmojmë bletëve që më lehtë të përgatiten për fazën e dimërimin.

Në këtë muaj duhet të vërtetohet prezencja dhe kualiteti i amës; rëndësi të veçantë duhet t'u përkushtohet shoqërive të roitura dhe rojeve të reja, si dhe atyre që kanë ngecje në zhvillim. Në këtë kohë ende mund të bëhet zëvendësimi i kornizave të këqija e të vjetra. Nëqoftëse vërehet bllokimi i shtrartit të larvave me mjaltë (në pjesën e kosheres ku zhvillohen larvat - fole), i njejtë duhet të deblokohet duke bërë zëvendësimin e kornizave me mjaltë me korniza me fletë dylli ose më hoje të gatshme, duke pasur kujdes që në koshere të ngel sasi e mjaftueshme e mjaltit (ushqimit) për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë. Kornizat e larguara nga kosherja mund të ruhen si rezervë, t'u jepen shoqërive tjera që kanë nevojë, ose po nga ato të nxirret mjalti e i njejtë t'u ipet bletëve si ushqim.

Është me rëndësi që gjatë aktivitetëve në këtë muaj të bëhet kujdes në paraqitjen e plaçkitjeve-grabitjeve në mes bletëve. Nëse vërejmë se bletët u sulen kornizave të nxjerrura dhe koshereve të hapura, atëherë duhet t'a ndërpresim punën.

Tash është koha e fundit të bëhet zëvendësimi i amave jorentabile, nëse deri tani s'janë ndërruar nga vetë bletët. Ndërimi i matkave mund të bëhet me matka të reja, ose po pas largimit të matkës t'a lëmë shoqërinë që vetë të nxjerrin amë të re.

Kornizat nga të cilat e kemi nxjerrur (centrifiguar) mjaltin tani mund t'i kthejmë në koshere duke i vendosur një kat poshtë magazinës së mjaltit (mjaltos). Kjo do të ndikojë në mënyrë stimuluese te bletët, të cilat për një kohë të shkurtër do t'i pastrojnë nga mjalti i mbetur në to.

Ende mund të formojmë roje të reja në këtë muaj, veçanërisht nëse posedojmë matka të mbarësuar. Megjithatë duhet patur parasysh se më së miri është që rojet e reja të formohen duke marrë korniza nga disa shoqëri (e jo vetëm nga një), që të mos vijë deri te dobësimi i një shoqërie.

Nëqoftëse vërehet përhapje e madhe e varroas (këpushes), duhet shoqëritë e bletëve të trajtohen kundër saj, por paraparakisht duhet të largohen magazinat e mjaltit. Gjithashtu duhet patur kujdes në paraqitjen e sëmundjes amerikane të larvave (American foulbrood). Gjithashtu kosheret duhet të mbrohen nga temperaturat e larta. Nuk duhet të vendosen korniza me mjaltë në kosheret me pak bletë, sepse mund të vijë deri te shkrirja e hojeve dhe derdhjes së mjaltit. Nëqoftëse afër bletores s'ka burim të ujit, i njejtë bletëve duhet t'u sigurohet me anë të enëve të posaçme. Korriku është muaj kur bëhet vjelja e propolisit. Prej tani duhet të merren masa për parandalimin e dëmtuesve, siç janë grerëzat dhe grethat, duke vendosur gracka me mish të prishur ose birra me sheqer.

**Vasko Karadakovski Sh.B. NEKTAR - Manastir**



## LISTA E NEONIKOTINOIDEVE

Pesticidet nga grupa e neonikotinoideve janë hemikale sistemike që ndikojnë nëpërmjet bimëve tek insektet të cilat i vizitojnë këto bimë për nektar dhe polen, duke e sulmuar sistemin e tyre nervorë.

Këto pesticide janë të njohur me emrat:

Klotianidin - Bayer UK978, Derer, Modesto, Poncho, Poncho 250, Poncho Beta, Raxil Deter, Redigo Deter (сите ги произведува Bayer CropScience).

Imidakloprid - Admire, Bayer uk 720, Baytan Secur, Bug free extra, Chinook, Chinook blue, Chinook colourless, Couraze, Gaucho, Imadasect, Intercept, Merit turf, Mido 70%, Neptune, Nuprid, Provado ultimate bug killer, Raxil secur, Tipod plus.

Fipronil - Regent IGR, Vi-Nil

Tiametoksam - Actara, Bug attack granules / liquid / quicksticks, Centric, Cruiser sb

Neonikotinoidet janë të ndaluara të përdoren në 4 shtete të BE-së: Itali, Gjermani, Slloveni dhe Francë.



Marrë nga gazeta: "The beekeepers Quarterly" numër 94, Dhjetorë 2008.



### Helmimi i bletëve nga tajimi i pesticideve nëpërmjet gjetheve të bimëve

Me të njejtin titull në Kongresin e 25-të të bletarëve profesional të Italisë më 21.01.2010 në Neapol u bënë të njohura rezultatet nga sudimet e prof. Vincence Girolamia nga Universiteti i Podovës. Bëhet fjalë për "djersitjen" e gjetheve të misrit, gjegjësisht tajimit të lëgut bimorë nga sistemi uhor i misrit apo ndonjë bime tjetër në formë të pikave që ngjajnë mjaft me vesën e mëngjesit e që për bletët apo insektet tjera paraqet burim të çmueshëm të ujit të cilin e mbledhin në orët e hershme të mëngjesit përpara se i njejtë të thahet nga dielli. Nëqoftëse farat e misrit janë të trajtuara me neonikotinoide (ganço, panço...), atëherë pikat që dalin nga

gjethi i këtyre bimëve në vete përmbajnë sasi të mëdha helmi që rezultojnë me ngordhjen e bletëve dhe insekteve tjera për 2-10 minuta. Prof. Andrea Taporo nga Universiteti i Kimisë në Podova ka bërë analizë të këtyra pikave dhe sipas saj në to gjinden deri 10mg materie helmuese për 1l lëng bimorë. Përqëndrimi vdekjeprurës për insektet është shumë më i vogël se kjo sasi. Mirëpo sipas Françesko Pandelës, kryetar i bletarëve profesional të Italisë, analizat e deritanishme vërtetojnë se ndikimi i insekticideve tek bletët ka qenë mjaft i dobët. Në bazë të këtyre analizave është dhënë leje për përdorimin e këtyre sistematikëve neurologjik.

- Problemi i ngordhjes së bletëve nuk do të zgjidhet me përdorimin e makinave moderne për mbjellje, po as edhe me përmirësimin e insekticideve në të cilat ngjitet poleni. – Të tilla ishin mendimet e disa ekspertëve të bujqësisë vitin e kaluar për këtë problematikë. - Zgjidhja duhet të gjindet sa më shpejtë, përderisa s'është bërë shumë vonë.

## LAJME NGA BOTA

Në debatin e njohur publik që mbahet një herë në vit në Angli më 20 Nëntorë, bleta është shpallur si gjallesa më e çmuar në planetin tonë – si lloji me rëndësi shumë të madhe në mbijetesën e planetit Tokë. Për fat të keq shumë njerëz s'janë të vetëdijshëm se çka paraqet bleta, e disa të tjerë as që dëshirojnë të dijnë!

Predrag Cvetković [www.pcela.rs](http://www.pcela.rs)

Komiteti Europjan për mbrojtjen e ambientit jetësorë vendosi masa të reja me qëllim të zvogëlimit të materieve helmuese të insekticideve dhe përdorimin e tyre në përgjithësi në bujqësi. Deri në fundin e vitit 2013 përdorimi i insekticideve duhet të zvogëlohet për 85%. Mendohet se një vendim i tillë do të has në kundërshtime dhe reagime nga ana e industrive kimike dhe farmerëve konvencional. Por, megjithatë anëtarët e komitetit qëndrojnë në qëndrimin e tyre se masat e tilla janë të pashmangshme e të njejtat duhet të realizohen.

Bletarëve të f. Radiçeviq në komunën e Beçejit ju kanë zhdukur (helmuar) bletët në 105 koshere, sepse në kohën e lulëzimit të pemëve, komuna ka dhënë urdhër për spërkatjen e pjesëve të pa mbjellura (zbrazëta) kundër rriqërave. Bletarët Cvetko Miçanović, Petar Vojnoviq dhe Bogdan Juras a kanë paraqitur rastin në polici dhe inspeksionet përkatëse dhe me ndihmën e avokatit kanë kërkuar dëmshpërblim nga Komuna Beçej në shumë prej 25000 euro. Bletarët i kanë grumbulluar të gjitha argumentet e duhura ndërsa për pagesën kanë edhe mbështetje ligjore, të cilën e ka pranuar edhe Komuna e Beçejit.



## Merops Apiaster

Në Vinicë dhe rrethinë bletarët kanë probleme serioze me dëmtuesin e njohur si Merops Apiaster. Ky shpend i rrallë dhe mjaft i bukur paraqet një ndër dëmtuesit më të madh të bletëve. Ushqehet me insekte, më së shumti me bletë. Në ditë ha 20-50 bletë.

Në ditët e ngrohta me diell ato nuk vërehen, sepse atëherë bletët i gjuajnë larg bletoreve, por kur moti është me shi, e veçanërisht pas shiut, atëherë gjenden rreth bletoreve ku ushqehen me bletë, të cilat kthehen nga kullota.

Gjithashtu edhe amëzat nuk bëjnë përjashtim, të cilat gjatë çiftëzimit në fluturimin e tyre martesorë bëhen pre e këtyre zogjve.

Përndryshe Merops Apiaster janë zogj shtegtarë dhe bëjnë pjesë në gjininë e dallëndysheve.

Përndryshe Merops Apiaster janë zogj shtegtarë dhe bëjnë pjesë në gjininë e dallëndysheve. Foletë e tyre i bëjnë në vende pothuajse të paarritshme, më së shpeshti në vende të larta ku gropojnë (çelin) vrima deri në 1 metër. Kujdesen shumë për të vegjëlit e tyre përderisa ata nuk fillojnë vetë të fluturojnë dhe ushqehen.


Nga vetë emri i tyre kuptojmë se këto zogj ushqehen me bletë dhe si pasojë u shkakotojnë dëme të mëdha bletarëve, prandaj duhet së bashku të merren masa për parandalimin e tyre duke e ulur numri e këtyre zogjve në një nivel të kënaqshëm, por asesi të zhduket plotësisht.

Ilço Kostadinovski Sh.B. MATICA- Vinicë

## FORMIMI I NUKLEUSËVE

### - Nukleuse të formuara ne pranverën e hershme (15.04) në DB ose LR.


Nukleuse të tilla formohen nga shoqëri të fuqishme ose mesatarisht të fuqishme. S'ka nevojë të kenë më shumë se 5 korniza, por në to të duhet të jenë përfshirë të gjitha grup moshat e bletëve. Një nukleusi të tillë ii pet matkë e mbarsuar ose qelëz të pjekur - arrirë (amzorë).



Kur do të bëhen 4 korniza me larva, nukleuset transferohen në koshere me 10 ose 12 korniza të tipit DB ose LR.

### - Nukleuse të formuara në mesin e verës (Korrik) nga shoqëri të dobëta, me matkë të re.


Këto nukleuse formohen nga shoqëritë të cilat kanë ngecur në zhvillim. Nga atom und të formohen 4-5 nukleuse, por duke u dhënë matka të reja të mbarësuar. Për formimin e tyre nuk nevojiten më shumë se 4 korniza, për arsye të temperaturave të larta verore dhe mundësisë për roitje. Këto nukleuse do të zhvillohen deri në dimër, dhe në sezonin e ardhshëm do të shërbejnë si shoqëri prodhuese.



Në pranverën e ardhshme transferohen në koshere me 10 ose 12 korniza të tipit DB ose LR.

### - Formimi i minikoshereve për prodhimin e matkave.

Ato formohen duke përdorur qelëza të arrira dhe shërbejnë si rezervë e fondit amë.



Shërbejnë për zëvendësimin e matkave të moshuara ose joproduktive